



REPUBLIKA E KOSOVËS

KOMUNA E LIPJANIT / OPŠTINA LIPLJAN / MUNICIPALITY OF LIPJAN

Bazuar në Vendimin nr.A-151/09 dt.08.10.2009 MMPH për anulimin e Aktvendimit Nr.9-351-128 dt.01.09.2009 dhe Vendimit të mëhershëm nr.A-55-1/09 dt.28.07.2009 MMPH për korrigjimin e pjesërisht të dispozitivit të Aktvendimit 9Nr.351-128 datë 10.07.2009 sipas kërkesë së Gani dhe Beqir Zekës të cilin e perfaqeson me autorizim av.Xhevdet R.Rama nga Prishtina dhe në bazë të nenit 96 të Ligjit për Procedurë të Përgjithshme Administrative Ligji Nr.02/ L-28, 22 korrik 2005, DUKMM merr:

AKTVENDIM PLOTËSUES PËR LEJE NDËRTIMI

- I. Bazuar në Vendimin nr.A-151/09 dt.08.10.2009 MMPH për anulimin e Aktvendimit Nr.9-351-128 dt.01.09.2009 si dhe Vendimi të mëhershëm nr.A-55-1/09 dt.28.07.2009 MMPH për korrigjimin e pjesërisht të dispozitivit të Aktvendimit 9Nr.351-128 datë 10.07.2009 anulohet Aktvendimi nr.09-351-128 datë 10.07.2009 i DUKMM KK Lipjan.
- II. Plotësohet Aktvendimi Nr.9-351-128 datë 01.09.2009
- III. Korrigjohet pjesërisht dispozitivi i Aktvendimit 9Nr.351-204 datë 26.09.2005 të DPU-Sektorit për urbanizëm dhe ndërtim, fjalët I LEJOHET investitorit Rexhep Zeka, me fjalët U LEJOHET investitorëve Beqir, Gani dhe Rexhep Zeka.
- IV. Ndersa pjesët tjera të dispozitivit të Aktvendimit 9Nr.351-204 dt.26.09.2005 mbesin të pandryshuar

Arsyetim

Gani dhe Beqir Zeka nga Prishtina me kërkesë ju ka drejtuar DUKMM – Sektorit për urbanizëm me kërkesë 9Nr.351-128 të datës 09.02.2009 për përmirësimin e një pjese të dispozitivit të Aktvendimit 9.Nr.351-204 datë 26.09.2005, në të cilin Aktvendimi nuk janë përfshi Gani dhe Beqir Zeka.

DUKMM – Sektori për Urbanizëm ju ka përgjigjur sipas Aktvendimit 9-351-128 dt.28/05/2009.

Kunder këtij Aktvendimi palët kanë ushtruar ankesë shkallës së dytë (MMPH – Prishtinë).

MMPH- ka vendosur në ankesën e tyre dhe ka marr vendim Nr.A-55/09 dt 22.06.2009 dhe lënda i kthehet për rishqyrtin DUKMM – Lipjan.

DUKMM- Sektori për Urbanizëm ka marrë Aktvendim Nr.9-351-128 dt 10/07/2009 që është refuzuar kërkesa e Gani dhe Beqir Zekës.

Përsëri kunder këtij Aktvendimi Nr.9-351-128 dt.10/07/2009 palët kanë ushtruar ankesë MMPH – Prishtinë, e cila ka marr vendim Nr.A-55-1/09 dt.28.07.2009, i cili vendim na obligon që të korrigjohet pjesërisht dispozitivi i Aktvendimit 9Nr.351-204 dt 26.09.2005, qka ky organ duke e zbatuar kete vendim ka vepruar si në dispozitiv të këtij Aktvendimi;

DUKMM –Sektorit për Urbanizëm ka marrë Aktvendim plotësues për leje ndërtimi 9-351-128 dt.01.09.2009.



Kundër këtij Aktvendimi Rexhep Zeka ka ushtruar Ankesë në MMPH-Prishtinë.
Përsëri MMPH-Prishtinë me Vendim Nr.A-151/09 dt.08.10.2009 dhe anulohet Aktvendimi Nr.9-351-128 dt.01.09.2009 dhe lënda kthehet në rishqyrtim me arsyetimin se lënda përmban te meta procedural, i mungon arsyetimi në bazë të të cilit është vendos.

Ky organ e rishqyrton lëndën dhe i eliminon te metat sipas vendimeve të MMPH.
Me qenë se është rast specifik i llojit të natyres së vet pjesët tjera të dispozitivit të Aktvendimit 9.nr.351-207 dt. 26.09.2005 mbesin të pandryshuar.

Në bazë të të cekurave më lartë dhe në harmoni të dispozitave ligjore u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Udhëzim Juridik: Kundër këtij Aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Ministries së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor - Prishtinë.

U dorëzohet:

- Parashtruesit të kërkesës
- në shkresat e lëndës
- arkivës

DREJTORATI PËR URBANIZËM, KADASTËR DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

SEKTORI për Urbanizëm

9-351-128

(Numri i Aktvendimit plotësues)

04/11/2009

(data)

Përpunoi:

Skënder Gërbeshi
Nëp.për ndërtim

Kontrolloi:

Idn nd.Hasim Vlshesella
Shef Sektori

Mendim Luma
Drejtor i DUKMM

Vendimi është i formës së prerë
Odluka je pravosnažna
Final Decision

3 Më 16.09. 2010

Dana _____

Verifikuar

